



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13 Prill 2021

Nr: 223

VENDIM

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR PËRZGJEDHJEN E MONITORUESIT
PËR TË PLOTËSUAR NUMRIN E 1 (NJË) VAKANCE NË QARKUN E LEZHËS**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit” dhe pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm

VËREN:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit, në përmbushje të detyrimit administrativ për njoftimin e palëve, si dhe në zbatim të udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”, shqyrtoi të gjitha aplikimet e depozituara dhe përzgjodhi listën prej 4 (katër) kandidatëve për monitorues, për plotësimin e vakancës së krijuar në qarkun Lezhë.

Të 4 (katër) kandidatët për monitorues plotësojnë kriteret e përcaktuara të udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”.

Për sa më sipër shorti për emërimin e monitoruesve u organizua për plotësimin e 1 (një) vakance të krijuar në qarkun e Lezhës.

Më datë 13.04.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin për përzgjedhjen e monitoruesit për qarkun Lezhë.

Në një kuti transparente u futen 4 (katër) gogla me formë, ngjyrë dhe peshë të njëjtë dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 4 (katër) kandidatëve për monitorues pjesëmarrës për qarkun Lezhë, nga të cilët u përzgjodh 1 (një) monitorues.



PËR KËTO ARSYE

Referuar nenit 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2 të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 01 datë 02.02.2021, “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”

V E N D O S:

1. Të miratoj z.Sebastiano Gjetja si monitorues për vakancën në qarkun Lezhë, i cili do të kryej monitorimin për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas rezultatit të shortit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 13 Prill 2021
Nr. 223

Për shpalljen e rezultatit të shortit për përzgjedhjen e monitoruesit për të plotësuar numrin e 1 (një) vakance në qarkun e Lezhës